



ZYRË PËRMBARIMORE PRIVATE 3L

93
23.02.2024

Nr. 156 prot

Durrës më 22.02.2024

URDHËR

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

TIRANË

Në Durrës, sot më datë 22.02.2024.

Unë **HARILLA A. ÇIPI** Përmbarues Gjqësor Privat me certifikatë Nr. 244 pranë Zyrës së Përmbarimit Private "3L" shpk pasi studiova dosjen përmbarimore si dhe në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 11-2023-7205 (1011) datë 27.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

KONSTATOVA

Se në datën 05.02.2024 Kreditori **Shoqëria "Solo Italia" shpk** ka paraqitur pranë Zyrës së Përmbarimit Private "3L" shpk kërkesën për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv Faturat Tatimore Nr. 720/2023 datë 07.08.2023, Nr. 701/2023 datë 05.08.2023 dhe Nr.1052/2023, datë 19.08.2023 se bashku me Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 11-2023-7205 (1011) datë 27.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me palë:

- **Kreditor** : Shoqëria "Solo Italia" shpk
- **Debitor** : Shoqëria "ROZAFA" shpk me NIPT: K48130547V
- **Me objekt** : Shlyerje Detyrimi


Pasi janë zbatuar procedurat ligjore të njoftimit drejtuar palës debitore për ekzekutim vullnetar të detyrimit, pala debitore nuk ka kryer ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit që përmban Titulli Ekzekutiv.

Me vendim të Përmbaruesit Gjqësor Privat ekzekutimi i Titullit Ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Në këto kushte kur për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit duhet të kryhet bllokimi i aksioneve të debitorit **Shoqëria "ROZAFA" shpk me NIPT: K48130547V, me administrator Z. Ritvan Gjergji**, me qëllim mostjetërsimin e tyre për të shmangur nga detyrimin.

Për sa më lartë si dhe mbështetur në nenet 519, 527, 593 të Kodit Procedurës Civile, në nenet 36/3, dhe 53 i Ligjit 26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjqësor Privat"





ZYRË PËRMBARIMORE PRIVATE 3L

URDHËROJMË:

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi aksioneve të debitorit **Shoqëria "ROZAFA" shpk me NIPT: K48130547V, me administrator Z. Ritvan Gjergji**, me qëllim mostjetërsimin e tyre për të shmangur nga detyrimi për ekzekutimin e Urdhërit Ekzekutimit.
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja , na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë , do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të Kodit të Proçedurës Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.
4. Ky urdhër mbahet në disa kopje dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

ZYRË PËRMBARIMORE PRIVATE

**"3L" SHPK
ADMINISTRATOR**

